

**PROCESI PJESEMARRËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË  
KOMUNËS SË GLLOGOCIT 2020-2028**



## Përmbajtja

|                                          |    |
|------------------------------------------|----|
| HYRJE .....                              | 3  |
| 1. PROCESI PJESËMARRËS.....              | 3  |
| • Takimet fillestare .....               | 3  |
| • Takimet konsultative informuese .....  | 3  |
| • Punëtoritë dhe .....                   | 3  |
| • Prezantime .....                       | 3  |
| • Shqyrtimi Publik.....                  | 3  |
| a. Takimet fillestare .....              | 6  |
| a. Takimet konsultative informuese ..... | 7  |
| b. Punëtoritë .....                      | 13 |
| c. Prezantime .....                      | 14 |
| d. Shqyrtimi Publik.....                 | 16 |
| 2. ANNEX.....                            | 61 |

## FOTOGRAFITË

|                                                                                                                                         |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Foto 1 Takimi fillestar me EKP.....                                                                                                     | 7  |
| Foto 2 Nga takimet informuese me 18 Qershor 2018.....                                                                                   | 8  |
| Foto 3 Takimet informuese me datë 19.06.2018.....                                                                                       | 8  |
| Foto 4 Takimet informuese me dt.20.06.2018 .....                                                                                        | 9  |
| Foto 5 Takimet informuese me datën 21 qershor 2018.....                                                                                 | 9  |
| Foto 6 Takimet informuese më 22 qershor 2018.....                                                                                       | 10 |
| Foto 7 Takimet informuese me dt.25.06.2018 dhe 26.07.2018.....                                                                          | 10 |
| Foto 8 Takimet informuese 27.06.2018.....                                                                                               | 10 |
| Foto 9 takime informuese më 28 qershor 2018.....                                                                                        | 11 |
| Foto 10 Përfaqësues të GIZ-it, kompanisë PLAN-A Consulting dhe zyrtarë të Komunës në takim me Kryetarin e<br>Komunës së Glllogocit..... | 12 |
| Foto 11 Takim me biznese, shoqësi civile, shoqatë të grave.....                                                                         | 13 |
| Foto 12 Punëtorja e Vizionimit me 10 deri më 12 Dhjetor 2018, në Hotel Sharri/Prevallë, Prizren.....                                    | 13 |
| Foto 13 Punëtorja për hartim të Planit të Veprimt me 2 dhe 3 Maj 2019 në Emerald Hotel.....                                             | 14 |
| Foto 14 Prezantimi i Gjendjes Ekzistuese në komunë të Glllogocit/8 Shkurt 2019 .....                                                    | 14 |
| Foto 15 Më 22 Maj 2019 në sallën e Kuvendit Komunal është bërë prezantimi i kornizës zhvillimore .....                                  | 15 |

## HYRJE

Ky raport përfshin Procesin e Konsultimeve gjatë hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK) së Glllogocit 2020-2028. Raporti përshkruan procesin pjesëmarrës nëpër faza të ndryshme të hartimit të planit me qëllim të arritjes së konsensusit mbi çështjet kyçe dhe me prioritetet. Konsultimet me pjesëmarrësit kanë qenë pjesë esenciale e procesit gjatë hartimit të PZHK-së.

Ky raport është hartuar nga Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor në bashkërendim me drejtoritë sektoriale të Komunës

## 1. PROCESI PJESËMARRËS

Gjatë procesit të hartimit të PZHK-së konsultimet kanë qenë mekanizëm që kanë mundësuar angazhimin kualitativ dhe efektiv të pjesëmarrësve të ndryshëm, bashkëpunim me institucionet dhe autoritetet të nivelit qendror ashtu dhe atë lokal. Duhet theksuar se përfaqësuesit nga të gjithë sektorët duke filluar nga ai publik, privat dhe nga shoqëria civile dhe me profesione të ndryshme kanë marrë pjesë aktivisht me qëllim të arritjes së zgjidhjes kolektive për sfidat zhvillimore që i ka komuna e Glllogocit.

Gjatë këtij procesi janë themeluar Grupet Punuese mbi Çështje-Specifike (fusha tematike), të përbëra nga përfaqësues të ndryshëm të pjesëmarrësve. Procesi ka filluar me Analizë të pjesëmarrësve sipas fushave tematike dhe ka qenë proces dinamik i cili ka ndihmuar në identifikimin e legjitimitetit, interesit dhe rolit të secilit pjesëmarrës në proces të hartimit të këtij plani. Kujdes i posaçëm është dhënë involvimit të grupeve të ndjeshme si ato të femrave, të moshuarve dhe atyre me nevoja të veçanta.


Për më tepër duhet të theksohet se gjatë procesit të hartimit të planit janë marrë parime themelore të Qeverisjes së Mirë: *Gjithëpërfshirja* - Mbledhja e të gjitha grupeve kyçe të pjesëmarrësve (përfshirë edhe grupet e përfaqësuara pak dhe grupet tjera të ndieshme), duke dhënë mundësi për grupet e tilla që të identifikojnë brengat e tyre, të shprehin pozitën e tyre dhe të përcaktojnë rolin e kontributit të tyre, *Procesi i vazhdueshëm*, *Përgjegjshmëria*, *Shprehja e vullnetit kolektiv*, *Bashkëpunimi*, *Konsenzusi dhe Fleksibiliteti*.

I tërë procesi pjesëmarrës ka qenë i strukturuar në disa forma të takimeve:


- Takimet fillestare
- Takimet konsultative informuese
- Punëtoritë dhe
- Prezantime
- Shqyrtimi Publik

Në mënyrë që procesi të jetë edhe më gjithëpërfshirës është shfrytëzuar platforma e komunikimit digjital i quajtur Maptionnaire (shiqo ANNEX/in). Gjatë periudhës prej 29 nëntor-11 dhjetor 2018 janë intervistuar 777 pjesëmarrës dhe janë pranuar 355 komente me ide për përmirësime të hapësirës dhe kërkesa rreth çështjeve të ndryshme në komunë.

Diagramet në vazhdim tregojnë numrin e të intervistuarëve përmes platformës, gjininë, moshën dhe se a jetojnë në Drenas apo jashtë saj. Pjesa dërmuese kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe kryesisht që jetojnë në Drenas.




Po ashtu të intervistuarit janë pyetur se në cilën pjesë të Drenasit: Drenas, në Qendër, Çikatovë të re, Lagjja e xhamisë, Lagjja e Feronikelit, Zona Komerciale dhe Zona Indistriale. Nga numri i përgjithshëm i të intervistuarëve, pjesa dërmuese kanë qenë nga Drenasi dhe Çikatova e re. Diagrami në vazhdim tregon numrin e të intervistuarëve dhe vendet që jetojnë.



Në vazhdim të intervistuarit janë pyetur se Plani a duhet të ndajë më tepër tokë për: shtëpi, ndërtesa shumëkatëshe, restorane, tregëtare, ndërmarrje të vogla dhe të mesme apo industri. Nga numri i përgjithshëm i të intervistuarëve është vërejtur se në Drenas kanë kërkuar më tepër ndërtesa banimi,

ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe shtëpi. Ndërsa Qendra, Çikatova dhe Lagjja e xhamisë ka kërkuar të ndahet tokë më tepër shtëpi banimi. Diagrami në vazhdim tregon mvarësisht nga vendi, kërkesat për ndarje të tokës ndërtimore.



Në annex të dokumentit janë bashkangjitur të gjitha komentet që janë marrë parasysh dhe inkorporuar gjatë hartimit të PZHK-së. Duke pasur parasysh kërkesat nga ky hulumtim, PZHK-ja ka adresuar të gjitha duke strukturuar kërkesat e tyre në fusha tematike. Kërkesa për vendbanime është adresuar përmes dendësisht brenda kufijve të vendbanimeve, konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese, ri-zhvillimit të hapësirave ekzistuese të ndërtuara si dhe plotësim të hapësirës së pa ndërtuar. Qyteti i Glllogocit do të vazhdojë të jetë qendër kyçe komunale për banim, biznes, aktivitete komerciale dhe industriale. Infrastruktura me e rëndësishme edukative, kulturore, sportive dhe shëndetësore do të përqendrohet në qytetin e Glllogocit. Të gjitha nën-qendrat do të ofrojnë shërbime, si dhe do të kenë mundësinë e akomodimit të aktiviteteve komerciale dhe industri. Përmes nënqendrave do të ofrohen shërbimet bazë siç janë çerdhet e fëmijëve, shkollim fillor dhe të mesëm, shkolla profesionale, shërbim kulturor, social dhe administrative dhe do të sigurohet toke e mjaftueshme ndërtimore për banim, biznese dhe industri. Kërkesa për nxemje është adresuar përmes ofrimit të ngrohjes qendrore për banim përmes ko-gjenerimit me KEK-un, duke qenë se infrastruktura bazë është prezente. Komuna do të ofrojë kushte për zhvillimin e politikave të banimit të përballueshëm. Sa i përket kërkesave për infrastrukturë rrugore është adresuar përmes zgjerimit të rrugëve dhe trotuareve dhe zgjerimi i rreth-rrotullimit në hyrje të Glllogocit si dhe zgjerimi i trotuarit dhe ndërtimi i atij në anën tjetër të rrugës Glllogoc-Poklek, në mënyrë që të evitohet tollovia e përditshme e makinave që hyjnë në Glllogoc dhe atyre që vazhdojnë për Skenderaj, si dhe tollovia dhe rreshti i gjatë i nxënësve që bëhet për të shkuar në shkollë të mesme dhe anasjelltas. Të gjitha rrugët në zonat urbane pajisen me trotuare në të dy anët, dhe në zonat rurale ato duhet të plotësohen me trotuare së paku në një anë të rrugës. Përveç trotuareve, rrugët kryesore duhet të pajisen me shteg të biçikletave dhe brez të gjelbërimit të ulët dhe të lartë. Gjelbërimi i lartë përgjatë rrugës është i

domosdoshëm për ofrimin e hijes gjatë ecjes, pastrimit të ajrit si dhe zvogëlimin të zhurmës. Janë adresuar edhe ceshtjet e sigurisë, transportit publik dhe ndotja akustike.

Kërkesat edhe për ujësjellës-kanalizim janë adresuar si në vijim: Rrjeti i ujësjellësit shpërndahet në vendbanimet tek të gjitha vendbanimet e mbetura jashtë rrjetit, pra shtrirja në Abri e Epërme, Arllat, Baicë, Domanek, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Godanc, Gradicë, Kishnarekë, Korroticë e Epërme, Likoshan, Negroc, Nekoc, Polluzhë, Sankoc, Shtuticë, Tërdec, Vasilevë, Vërboc dhe Vuçak. Ndërsa, në Gllanasellë, Dobroshec dhe Llapushnik duhet të plotësohet dhe kompletohet rrjeti ekzistues i ujësjellësit.

Kanalizimi: Rrjeti i kanalizimit shpërndahet në vendbanimet të cilat nuk kanë rrjet të kanalizimit, pra në Gllanasellë, Gllobar, Terstenik, Verboc, Gradicë, Likoshan dhe Shtuticë. Të gjitha vendbanimet duhet të pajisen me rrjet kanalizimi që bën trajtimin mekanik dhe fizik, duke eliminuar gradualisht prezencën e gropave septike. Përmirësimi i Cilësisë së shërbimeve shëndetësore (diagnostikimi, trajtimi dhe parandalimi i sëmundjeve, lëndimet dhe dëmtimet të tjera fizike dhe mendore, etj.) adresohet përmes ndërtimit të dy Ambulancave në Baicë dhe Abri dhe renovimin e objekteve ekzistuese në Tërstenik dhe Gllanasellë. Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Kërkesat kanë qenë edhe për mbrotjen nga ndotja, ku PZHK-ja adreson përmes matjeve të vazhdueshme të përqendrimit SO<sub>2</sub>, CO, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub> dhe përqendrimit të pluhurit në qendër të qytetit dhe vendbanimet afër Feronikelit dhe atë në mënyrë periodike (min 1 herë në muaj) me stacione mobile rreth e rrotull Feronikelit dhe deponive në Çikatovë të Vjetër dhe të bëhet vendsja e filtrave. Ndikimi i fabrikës së Feronikelit do të monitorohet dhe mbikqyret duke respektuar kushtet e lejes së integrimit mjedisore dhe ligjet tjera në fuqi, dhe po ashtu komuna në rastin e Feronikelit duhet të kërkojë zbatimin e parimeve “ndotësi paguar” dhe “shfrytëzuesi paguar”, përmes impimentimit të projekteve të gjelbrimit dhe projekteve tjera për përmirësimin e mjedisit. Si masë mbrojtëse është edhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Dobroshec. Deponitë ilegale, eksploatimi i drurit dhe zhavorrit janë sfida shtesë më të cilat ballafaqohet komuna e Glllogocit prandaj duhet të bëhet mbyllja-eliminimi i deponive ilegale dhe shëndërimi i tyre në hapësira të gjelbra që mund të shfrytëzohen nga ana e qytetarëve. Ndërsa eksploatimi i drurit dhe zhavorrit adresohet me monitorim të rregullt nga ana e komunës dhe aprovimi i rregulloreve që parasheh gjëritjen. Pasi që skorja nga Feronikeli e mbulon një hapësirë prej 24 ha dhe zona e ndikimit është 45 ha atëherë parashihet që rreth skorjes të ketë tampon zonë nga gjelbërimi që do të pengonte shpërndarjen e pluhurit në pjesë tjera të territorit dhe njëkohësisht do të pasuronte ajrin me sasi të oksigjenit.

Kërkesat për zhvillim ekonomik janë adresuar përmes zhvillimit të bujqësisë dhe mbrojtjes së trashëgimia kulturore dhe zhvillimit të turizmit.

#### **a. Takimet fillestare**

Me dt.13.04.2018 janë mbajtur takimet e para konsultative me Ekipen Komunale të Planifikimit (EKP) dhe me Ekipen e Këshilluesve të Komunitetit (EKK). Në të dy takimet ka pasur diskutime të frytshme ku është mirëpritur mjaftë me interesim iniciativa për Hartimin e PZHK-së dhe HZK-së për Komunën e Drenasit.



*Foto 1 Takimi fillestar me EKP*

#### **a. Takimet konsultative informuese**

Duke pasur parasysh rëndësinë e takimeve konsultative në tërë territorin e komunës së Glllogocit, zyrtarët komunal kanë informuar pjesëmarrësit paraprakisht me anë të ftesave si në vijim. Në këto takime kanë qenë prezent 175 veta që kryesisht kanë qenë banorë të komunës ku është dhënë mundësia e barabartë të gjithëve që të shprehin shqetësimet, sfidat në vendbanimet që jetojnë.

Takimi i parë konsultativ me qytetar në fshatrat Tërstenik, Vërboc, Shtuticë dhe Polluzhë është mbajtur me 18 Qershor 2018, qëllimi i të cilit ishte të informojë qytetarët dhe të diskutohet procesi e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Komuna e Glllogocit është deklaruar se pret nga qytetarët të jenë pjesëmarrës aktiv në të gjitha fazat e hartimit të dokumenteve.



Me datë 19.06.2018, komuna ka vazhduar takimet konsultative në bashkësinë lokale Gllanasellë dhe në fshatrat Gllanasellë, Gradicë, Godanc, Dobroshec, Likoshan dhe Çikatovë e Vjetër.



Me dt.20.06.2018 në ora 17:00 janë mbajtur takimet konsultative informuese në Zabel i Ulët ku janë ftuar të gjithë banorët e fshatrave Zabel i Ulët, Korroticë e Ulët, Korroticë e Epërme, Poklek dhe Vasilevë.

pg. 8

## Raporti i shqyrtimit publik dhe procesit pjesëmarrës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028



Foto 4 Takimet informuese me dt.20.06.2018

Takimet konsultative kanë vazhduar edhe me datën 21 qershor 2018 në Komoran ku në mënyrë të njajtë është diskutuar dhe janë informar banorët për hartim të planeve dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në proces të hartimit.



Foto 5 Takimet informuese me datën 21 qershor 2018

Më 22 qershor 2018 takimet konsultative janë mbajtur në Sankoc.



## Raporti i shqyrtimit publik dhe procesit pjesëmarrës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028

Foto 6 Takimet informuese më 22 qershor 2018

Ndërsa me dt.25.06.2018 në ora 17:00 kanë vazhduar takimet në Arllat në shkollën Abedin Bujupi, kurse me dt.26.07.2018 në ora 17:00 në Çikatovë të Re në shkollën Ali Gashi.




Foto 7 Takimet informuese me dt.25.06.2018 dhe 26.07.2018

Me datën 27.06.2018 në ora 17:00 kanë vazhduar takimet në Baicën ë shkollën "Migjeni" ku kanë qenë të ftuar banorët nga zonat Baicë, Damanek, Abri dhe Tërdec.



Foto 8 Takimet informuese 27.06.2018

Më 28 qershor 2018 janë ftuar qytetarët nga Drenasi dhe me gjerë, që të marrin pjesë në takime informuese e cila është mbajtur në Shkollën "Rasim Kiqina", në ora 17:00.



*Foto 9 takime informuese më 28 qershor 2018*

Gjatë datave 22, 23 dhe 24 janë organizuar një sërë takimesh me përfaqësues të ndryshëm duke filluar nga bizneset deri te orgnizatat mjedisore, organizata të grave etj. . Fillimisht është informuar kryetari i komunës në lidhje me zhvillimet e mundshme dhe skenaret për komunë të Gllogocit. Nga ana e kryetarit janë ngritur këto çështje:

- nuk duhet të ketë zhvillime në toka të komasacionit ato duhet të kufizohen
- në 2014 është ndryshuar koeficienti i ndërtimit por kryetari ka analuar atë vendim
- duhet të konsiderohet që një pjesë e Drenasit është ndërtuar mbi pllaka të thëngjillit dhe asesi nuk duhet të ketë ndërtim
- Fshatrat që janë nën komasacion nuk dhet të zhgjerohen më tepër por edhe ato që nuk janë të parashihet densifikim
- Komorani duhet të ruajë kufijtë ekzistues dhe zhvillimet të bëhen brenda këtyre kufijve ngase jashtë është e rrethuar me prona të komasacionit
- Pishinë gjysëm olimpike - është miratuar buxheti Komoran
- Planifikohet zhvillim më i madhë afër Goleshit tek lokacioni i stadiumit të ri dhe afër parkut të biznesit por të jetë industri e lehtë
- pronat që janë nën menaxhim të AKP dhe private planifikohet shpronësim i tyre
- planifikohet banim individual për familje të dëshmorëve
- Liqeni akumulues për ujë të pijshëm në Gubavc për 40 000 banorë, me shtigje të ecjes. studimi i fizibilitetit është duke u punuar
- Planifikohet parkingu nëntokësor ku pronat e komunës mund të jepen në konsecion
- Çiçavicë - planifikohet rruga që mund të lidhet me 5 komuna (Besarti e ka skicën) bashkë me pjesët me rekreacion
- Kosmaq - 2 burime të ujit të pijshëm
- Kalatë duhet të theksohen më shumë
- Zona e Kleqkës, Divijakës në Lipjan (me 3 komuna) planifikohet të hapet rruga dhe të bëhet zonë turistike (tek kisha, Besarti detalet)
- planifikohet tramvaj që do të lidhet me linjen Prishtinë - aeroport

## Raporti i shqyrtimit publik dhe procesit pjesëmarrës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Gllgocit 2020-2028

- lidhja e stadiumit me hekurudhë (Besarti) kah Komorani ose kroni i Mbretit
- trajtimi i ujërave të zeza në lumenj, lokacioni është caktuar në Sitnicë
- Feronikeli nuk ndot aq shumë sa thuhet, janë filterat. Përpunohen xehjet nga Indonezia, Shqipëria dhe vendet tjera
- Skorja planifikohet të mbulohet dhe të gjelbrohet
- Ekzistojnë gypat e gazifikimit të Feronikelit që mund të përdoren për ngrohje. Planifikohet të përdoret uji i ngrohtë i KEK'ut..komuna është në negociata me Feronikelin



Foto 10 Përfaqësues të GIZ-it, kompanisë PLAN-A Consulting dhe zyrtarë të Komunës në takim me Kryetarin e Komunës së Gllgocit

Në takime me biznese, shoqësi civile, shoqatë të grave etj është diskutuar rreth kornizës zhvillimore të komunës, sfidat duke potencuar zhvillimi i dobët ekonomik dhe ndotjen e mjedisit dhe mundësitë zhvillimore. Për më tepër është theksuar nga ana e ekspertëve që të gjitha sfidat do të merren parasysh dhe duke përfshirë edhe potencialin ekzistues të komunës do të ndërtohet korniza zhvillimore.



*Foto 11 Takim me biznese, shoqësi civile, shoqatë të grave*

#### **b. Punëtoritë**

Në kuadër të punëtorive janë organizuar disa duke filluar nga ajo e Vizionimit që është mbajtur prej 10 deri më 12 Dhjetor 2018, në Hotel Sharri/Prevallë, Prizren. Në këtë punëtori janë diskutuar dhe është hartuar Vizioni i komunës së Glllogocit. Pjesëmarrësit kanë qenë të gjitha grupet e interesit duke filluar nga shoqëria civile deri tek zyrtarë të nivelit qendror. Metodologjia e punës është bazuar në punë grupore ku pjesëmarrësit janë ndarë në grupe bazuar në temat zhvillimore për të gjitha sektorët e komunës. Njëkohësisht janë hartuar qëllimet dhe objektivat që shërbejnë si udhërrëfyes për arritjen e vizionit të planit. Në punëtori kanë qenë prezent përfaqësuesit e drejtorive të komunës, kompanitë publike, kryetarët e bashkësive lokale, administratorët e fshatrave, OJQ, përfaqësues të kompanive ndërtuese, përfaqësues të minoriteteve, dhe profesionistë të fushës.



*Foto 12 Punëtoritë e Vizionimit me 10 deri më 12 Dhjetor 2018, në Hotel Sharri/Prevallë, Prizren*

Në kuadër të grupit të punëtorive është mbajtur edhe punëtoritë dy ditore me 2 dhe 3 Maj 2019 për hartim të Planit të Veprimet. Në punëtori kanë qenë prezent përfaqësuesit e drejtorive të komunës, kompanitë publike, kryetarët e bashkësive lokale, administratorët e fshatrave, OJQ, përfaqësues të kompanive ndërtuese, përfaqësues të minoriteteve, dhe profesionistë të fushës. Të gjithë pjesëmarrësit kanë qenë të ndarë në 5 grupe punuese sipas fushave tematike. Punëtoritë është finalizuar me sukses ku janë identifikuar të gjitha veprimet që do të adresojnë qëllimet dhe objektivat e planit



*Foto 13 Punëtorja për hartim të Planit të Veprimit me 2 dhe 3 Maj 2019 në Emerald Hotel*

### **c. Prezantime**

Me qëllim të informimit dhe ofrimit të mundësisë për të komentuar në Gjendje Ekzistuese në komunë të Glllogocit më 8 Shkurt 2019 është mbajtur prezantimi publik ku kanë qenë të ftuar përfaqësues të institucioneve, shoqëria civile, ekspertë lokalë, zyrtarë komunaklë, qytetarë etj. Fillimisht pjesëmarrësit janë përshëndetur nga drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Z. Flutura Avdiu e cila theksoi se me hartimin e këtij Planit Zhvillimor Komunal, Glllogocit do t'i hapen dyert e një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe ka kërkuar nga të gjithë që të japin rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerime të tyre në mënyrë që ky plan të jetë sa më i plotësuar dhe më i dobishëm për qytetarët e komunës.

Prezantimi ka përfshirë informata mbi gjendjen ekzistuese në sektorët e ndryshëm si në mjedis, infrastruktura rrugore, ujore, gjelbërimet, bizneset, kultura dhe fusha të tjera.



*Foto 14 Prezantimi i Gjendjes Ekzistuese në komunë të Glllogocit/8 Shkurt 2019*

Më 22 Maj 2019 në sallën e Kuvendit Komunal është bërë prezantimi i kornizës zhvillimore në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal.

Të pranishëm ishin kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci i cili edhe mbajti një fjalim dhe falënderoj mbështetësit e hartimit të PZHK-së si dhe grupin punues për kontributin e dhënë në finalizimin e këtij plani i cili parasheh zhvillimin e Komunës së Glllogocit për tetë vitet e ardhshme.

Në takim ishin, drejtoresha e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përfaqësues të GIZ-it gjerman, përfaqësues të KEDS-it, të ujësjellësit rajonal "Prishtina" si dhe grupi punues për hartimin e PZHK-së.

## Raporti i shqyrtimit publik dhe procesit pjesëmarrës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028



*Foto 15 Më 22 Maj 2019 në sallën e Kuvendit Komunal është bërë prezantimi i kornizës zhvillimore*

Me datë 02.12.2019, u mbajtë prezantimi i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit, në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Giz-it gjerman, ku u bë një prezantim rreth përmbajtjes së draftit të Pzhk-së, vizioni, qëllimet dhe objektivat e tij, si dhe harmonizimi i dokumentit me planet e nivelit qendror. Një hap i rëndësishëm për të shkuar me tutje me procesin e hapjes së shqyrtimit publik të Pzhk-së së Glllogocit 2020-2028.



*Foto 16: Me datë 02.12.2019, gjatë prezantimit të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit, në prani të përfaqësuesve të MMPH dhe Giz.*

#### d. Shqyrtimi Publik

Në mbledhjen e datës 31.01.2020 miratohet propozimi për hapjen zyrtare të Shqyrtimit Publik sipas pikave të cekura në vendim (në vazhdim I bashkangjitur). Kryetari i Komunës së Glllogocit, Ramiz Lladrovci, me datë 05.02.2020 bëri hapjen zyrtare të shqyrtimit publik të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028. Në hapje morrën pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve dhe të interesuarve nga fusha të ndryshme zhvillimore që patën mundësinë të informohen rreth PZHK përmes prazantimit të gjitha fazave të PZHK-së (shih shtojcën). Qëllimi i këtij prezantimi ishte që të zhvillohen konsultime dhe që të inkurajohet pjesëmarrja transparente e publikut në hartimin e këtij dokumenti strategjik multisektorial.

Në mënyrë që i githë procesi të jetë në hamoni me legjislacionin në fuqi janë marrë parasysh përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor , në bazë të nenit 12 duke publikuar në faqen zyrtare të Komunës.

Republika e Kosoves  
Glllogoc

kerko ketu

ALB

Fillimi Komuna Lajmet Shpalljet Sherbimet **Projektet** Vendimet Raportet Prokurimi Qyteti Videot Raporto problemet

TË GJITHA

BUXHETI

PLANET ZHVILLIMORE

PROJEKTET E REALIZUARA

PROJEKTET KAPITALE

PROJEKTET PER MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**PROJEKTET**

2020 2019 2018 2017 2016 2015 Tjera

PROCESI PJESEMARRËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GLLLOGOCIT 2020-20 PDF  
publikuar:13/03/2020

Draft-RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E PUNËS NË INSTITUCIONET E DUKATIVE-ARSIMORE NË KOMUN PDF  
publikuar:14/02/2020

Draft-STATUTI I QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "DR. HAFIR SHALA" NË DRENAS DOC  
publikuar:14/02/2020

Draft Plani Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 PDF  
publikuar:05/02/2020

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024 PDF  
publikuar:15/01/2020

**ADRESA**  
Rr. "Fehmi Lladrovci" Drenas  
Kodi postal: 13000

**VEGEZA**  
• Webfaqja e vjeter e komunes  
• Gazeta zyrtare  
• Portali i Qeverisë  
• Prokurimi publik i Kosovës

**FAQET**  
Drenas  
GEOportal

**RRJETET SOCIALE**  
f t G+ y

Kryetari i Komunës i njoftoi të pranishmit se bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr.04 /L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Glllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës dhe se ky proces deri në finalizim të PZHK-së, ka kaluar nëpër këto faza kryesore siç janë: Profili i gjendjes ekzistuese; Vlerësimi i gjendjes ekzistuese; Koncepti i zhvillimit hapësinor; Prioritetet strategjike; Plani i veprimit.

Të gjitha fazat në procesin e hartimit të PZHK-së janë përcjellë me pjesëmarrje aktive të qytetarëve, dhe me mbajtjen e punëtorive që kanë shërbyer si mjet për të diskutuar përmbajtjet e çdo kapitulli të PZHK-së.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik qytetarët e Komunës së Glllogocit kanë pasur mundësi që të japin vërejtjet, komentet dhe sugjerimet, të cilat pastaj do të inkorporohen në dokumentin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2020-2028.

Kryetari Lladrovci ka falënderuar kontribuuesit e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal siç janë: Ekipi Komunal i Planifikimit, Ekipi Këshillues i Komunitetit, GIZ-in gjerman, Kompaninë hartuese Plan A Consulting, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Institutin për Planifikim.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**Komuna e Drenasit**  
**Kuvendi i Komunës**



**Nr. 12-400/01-5816 dt 31.01. 2020**

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 2 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12 dhe 14, sipas Vendimit Nr.6225-2/19 të datës 16.01.2020 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Bazuar në nenit 11,12 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën, 31.01.2020, miratoj këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROJEKT-PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL**  
**TË GLLOGOCIT PËR PERIUDHËN 2020-2028**

**Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj propozim vendimin për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

**Neni 2**

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 bëhet në sallën e Kuvendit Komunal.

2.2 Shqyrtimi publik i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Glllogocit 2020-2028 zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.3 Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 bëhet tetë ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht ueb faqës së Komunës.

**Neni 3**

3.1 Në shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

3.2 Në shqyrtimin publik prezantohen fazat e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028: Korniza Strategjike, Profili i Komunës, vlerësimi i gjendjes, vizioni, qëllimet dhe objektivat, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe Plani i veprimit.

3.3 Projekt- Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 është i qasshëm, për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

#### **Neni 4**

4.1 Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve, me shkrim, në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

#### **Neni 5**

Shqyrtimi publik i Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 organizohet nga Komuna në kuadër të kompetencave ligjore.

#### **Neni 6**

6.1 Me këtë propozim vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

6.2 Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi do të jetë edhe plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik (prezantimi i PZHK-së, njoftimi i qytetarëve, sigurimi i materialit elektronik dhe fizik i PZHK-së dhe veprimet tjera për të siguruar një qasje normale të qytetarëve në Planin Zhvillimor Komunal).

#### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.


#### **Neni 8**


Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

Kryetari i Kuvendit të Komunës  
Halil Halilaj





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria e Sekretarit/Office of the General Secretary

|                        |                                                                                                                               |
|------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATE/A:                | 16.01.2020                                                                                                                    |
| REFERENC-E:            | ZSP - 23/2020                                                                                                                 |
| PËR/ZA/TO:             | Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Glllogocit                    |
| CC:                    | Ramiz Lladrovci, Kryetarit të Komunës së Glllogocit                                                                           |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                                                                                               |
| NGA/OD/FROM:           | Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së                                                                               |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Njoftim për marrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt- "Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2019-2027" |



E nderuara znj. Avdiu,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 paragrafi 1.9 dhe nënparagrafi 1.9.1, Komuna e Glllogocit ka dorëzuar Projekt "Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2019-2027" në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 16.12.2019 me numër të protokollit 6225-2/19 për të verifikuar përputhshmërinë me "Planin Hapësinor të Kosovës -Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" para shqyrtimit publik, si dhe me nenin 9 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3, me të cilën Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projekt Planin Zhvillimor të Komunës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit dhe verifikimit të Planit Zhvillimor të Komunës që është në përputhje me "Planin Hapësinor të Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ

MMPH-Nr.08/2017 Për Normal Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor nxjerr Vendim për pëlqim që Kuvendi i Komunës së Gllgocit sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit dhe Menaxhimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik,

Me respekt,

## Raporti i shqyrtimit publik dhe procesit pjesëmarrës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028

---



## Raporti i shqyrtimit publik dhe procesit pjesëmarrës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028

---



e.Përmbledhja e komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve të aktiviteteve të shqyrtimit publik

| N<br>r. | Lokacioni i parcelës                                                               | Parashtru<br>esi /data                               | Komenti/ vërejtja                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Aprovohet<br>/refuzohet | Arsyetimet për miratim apo<br>refuzim të propozimeve dhe<br>vërejtjeve të qytetarëve.                                                                                                                                                                                                     |
|---------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.      |  | <p><b>Selman Sinani</b></p> <p><b>10.02.2020</b></p> | <p>Pronar I parceles nr.92 me siperfaqe 0-51-62 Ha dhe parceles me nr.120 me siperfaqe 0-18-17 Ha ne zonene e Drenasit, me lokacion ne anen e djathte te rruges Drenas-komoran, para ures se lumit Drenica. Qe te keni parasysh projektin e ri te lumit Verboci qe lidhet me lumen Drenica qe k ate bej me ndryshimin e parceles nr.120 me siperfaqe prej 0-18-17 Ha (per kete ndryshim kame lejen dhe vendimin nga drejtoria e ujerave – ministria). Qe ekipi komunal per Pzhu dhe harte zonale te kete parasysh dhe te perfshij ne siperfaqe te Pzhu dhe harte zonale kete zone duke u mbeshtetur ne arsyeshmerit:</p> <p>- Siperfaqja e propozuar kufizhet me rrugen Drenas – komoran dhe lumen Drenica (krahu I lumit Verboc)</p> | Refuzohet               | <p>Në bazë të ligjit Nr.02/L-26 për tokën bujqësore, neni 15:</p> <p>Shfrytëzimi I tokës bujqësore në sistemin e ujitjes përcakton se tokës bujqësore në sistemin e ujitjes nuk mund t`I ndrohet destinimi I shfrytëzimit, përveç ngritjes së objekteve me rëndësi të veçant publike.</p> |

|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |  |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  |  | <p>- Kjo sipërfaqe nuk mund të perdoret për qëllime bujqësore sepse kufizohet si më lartë</p> <p>- Në këtë sipërfaqe nuk ekzistojë as gypa as puseta të hidrosistemit “Iber-Lepenc”.</p> <p>- Sipërfaqja në fjalë ka pak mundësi shfrytëzimi bujqësor sepse afërsia me rrugën krijon ndotje në produktet bujqësore.</p> <p>Anda duke pasur parasysh arsyeshmerinë</p> <p>e lartëcekur është me se e nevojshme përfshirja e kësaj sipërfaqe në kufinjtë e Pzhu dhe të jetë sipërfaqe e trajtuar në Hartimin e Hartes Zonale të Drenasit</p> |  |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

|    |                                                                                    |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|----|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2. |   | <p><b>Afrim Gjeli</b></p> <p><b>10.02.2020</b></p> | <p>Unë Afrim Gjeli, Administrator I Poklekut te Ri kërkoj nga ana juaj qe te njihet e drejta e banoreve te Poklekut te Ri per tu varrosur ne varrezat e propozuara sipas Planit Zhvillimor, me konkretisht parcelen me nr 682.</p> <p>Paraprakisht ju faleminderoj per perkrahjen ne realizimin e kerkeses sime.</p>                                                                      | <p>Aprovohet</p> | <p><b>ARSYETIM</b></p> <p>Propozimi juaj është shqyrtuar.</p> <p>Në bazë të Pzhk-së është përcaktuar lokacioni për varreza në këtë parcel.</p> <p>Më tutje kërkesa juaj duhet t'i drejtohet organeve përgjegjëse (Drejtorisë së Shërbimeve Publike) meqenëse është kërkesë teknike që nuk trajtohet me Pzhk (Dokument Strategjik).</p> |
| 3. |  | <p><b>Selman R. Sinani</b></p>                     | <p>Propozim per draftin e Planit Zhvillimor Komunal;</p> <p>Une Selman R Sinani pronar I parces nr.92 me siperfaqe 0-51-62 Ha, dhe parces nr.120 me siperfaqe 0-18.17 Ha ne zonen e Drenasit, lokacioni ne anene e djathte te rruges regjionale Drenas-Komorani, para ures se lumit Drenica.</p> <p>Propozoj:</p> <p>Qe te keni parasysh projektin e ri te lumit Verboci qe lidhet me</p> | <p>Refuzohet</p> | <p><b>ARSYETIM</b></p> <p>Në bazë të ligjit Nr.02/L-26 për tokën bujqësore, neni 15:</p> <p>Shfrytëzimi I tokës bujqësore në sistemin e ujitjes përcakton se tokës bujqësore në sistemin e ujitjes nuk mund t'i ndrrohet destinimi I shfrytëzimit, përveç ngritjes së objekteve me rëndësi të veçant publike.</p>                      |


|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |  |  |
|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  |  | <p>lumen Drenica qe k ate bej me ndryshimin e parceles nr.120 me siperfaqe prej 0-18-17 Ha (per kete ndryshim kame lejen dhe vendimin nga drejtoria e ujerave – ministria).</p> <p>Qe ekipi komunal per Pzhu dhe harte zonale te kete parasyshe dhe te perfshij ne siperfaqe te Pzhu dhe harte zonale kete zone duke u mbeshtetur ne aryeshmerit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Siperfaqja e propozuar kufizhet me rrugen Drenas – komoran dhe lumen Drenica (krahu I lumit Verboc)</li> <li>- Kjo siperfaqe nuk mund te perdoret per qellime bujqesore sepse kufizohet si me larte</li> <li>- Ne kete siperfaqe nuk ekzistojte as gypa as puseta te hidrosistemit “Iber-Lepenc”.</li> <li>- Siperfaqja ne fjale ka pak mundesi shfrytezimi bujqesor sepse afersia me rrugen krijon ndotje ne produktet bujqesore.</li> </ul> <p>Andaj</p> |  |  |
|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

|    |                                                                                    |                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |           |                                                            |
|----|------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------------------------------------------------|
|    |                                                                                    |                                                         | <p>Duke pasur parasysh arsyeshmerine e lartecur eshte me se e nevojshme perfshirja e kesaj sipërfaqe ne kufinjt e Pzhu dhe te jete sipërfaqe e trajtuar ne Hartimn e Hartes Zonale te Drenasit</p> <p>Rikujtim I kerkeses me dt. 16.09.2019 me nr.port.08-070-54663.</p>                                                                                                      |           |                                                            |
